



BASHKIA
LEZHË




Raporti Mjedisor

Ndërtim muri mbrojtës i trotuarit të segmentit Rruga e Kunes "FRAN IVANAJ"



RAPORTI PARAPRAK I VLERESIMIT TE NDIKIMIT NE MJEDIS

Objekti: "Ndërtim muri mbrojtës i trotuarit të segmentit Rruga e
Kunes "FRAN IVANAJ"



PERMBAJTJA E RAPORTIT TE VNM-SE SE PARAPRAKE

- Hyrje
- Përshkrim i legjislacionit në fuqi
- Te dhenat për shtrirjen e objektit
- Informacion për qëllimin e vnm dhe metodikën e zbatuar
- Përshkrimi i mbulesës bimore të sipërfaqes
- Informacion për praninë e burimeve ujore, në sipërfaqen e projektit dhe në afërsi të tij
- Informacion lidhur me identifikimin e ndikimeve të mundshme, negative, në mjedis, të projektit, përfshirë ndikimet në biodiversitet, ujë, tokë dhe ajër si dhe në përshkrim për shkarkimet e mundshme në mjedis, të tilla si: ujëra të ndotura, gaze dhe pluhur, zhurma, vibrime, si dhe për prodhimin e mbetjeve;
- Informacion për kohezgjatjen e mundshme të ndikimeve negative të identifikuara
- Mundësinë e rehabilitimit të mjedisit të ndikuar dhe mundësinë e kthimit të mjedisit të ndikuar të sipërfaqes në gjendjen e mëparshme si dhe kostot financiare të përafërta për rehabilitimin
- Masat e mundshme për shmangien dhe zbutjen e ndikimeve negative në mjedis;

HYRJE

Vlerësimi i Ndikimit Mjedisor identifikon, përshkruan dhe vlerëson efektet direkte të projektit tek njerezit, flora dhe fauna, ujërat sipërfaqësore dhe nëntokësore, klimën, terrenin dhe ndërtimi tij si dhe ndërveprimin e këtyre faktorëve me trashëgimie kulturore, sociale dhe mjedisore. Kjo temë është bazuar në parimet e veprimeve të parandalimit, dhe si e tillë politika më e mirë konsiston në mënjanimin e ndotjes dhe problemeve të tjera që janë ngritur.

Ky raport paraprak i vleresimit të Ndikimit në mjedis hartohet me kërkesë të Bashkisë lezhe për realizimin e projektit "Ndërtim muri mbrojtës i trotuarit të segmentit Rruga e Kunes "FRAN IVANAJ".

Raporti parashikon ndikimet në mjedis nga punimet e realizimit të projektit për zhvillime urbane, menaxhimin e mbetjeve apo shkarkimin e ujerave të ndotura nga aktiviteti ndertimor në kantierin e ndertimit.

Tipologjia e raportit

Ky raport u mbështet në pika 10/b "Projekte për zhvillime urbane, duke përfshirë dhe ndërtimin e qendrave tregtare dhe parkimet për makinat", e Shtojcës II, Nr.10 440, datë 7.7. 2011 (I ndryshuar me ligjin 12/2015), për Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis

Studimi i Vlerësimit Paraprak të Ndikimit në Mjedis, do të marrë parasyh sugjerimet dhe bashkëpunimin me ekspertët dhe specialistet rajonale e vendore, në bazë të eksperiencave dhe përvojave të tyre, materialet ekzistuese, gjetjet e studimeve paralele, konsultime të vazhdueshme me palët e interesuara, që mundësojnë një përpunim të materialit të fokusuar në vlerësimin e ndikimeve, planin e menaxhimit dhe programin e monitorimit.

PËRSHKRIM I LEGJISLACIONIT NË FUQI

Gjatë dhjetë-vjecarit të fundit qeveria ka filluar zhvillimin e një kuadri ligjor dhe ka ndërmarre nisma te ndryshme për të ndryshuar degradimin mjedisor me synimin kryesor:

“Të mirëmbajë një mjedis të përshtatshëm të shëndetshëm dhe ekologjik për brezat e sotëm dhe të ardhshëm”.

Për më tepër, Legjislacioni kërkon që burimet natyrore duhet të shfrytëzohen racionalisht në përputhje me principe të bazuara. Politikat e përpiluara për mjedisin janë pasqyruar në ligjin e vitit 2011.

Kreu IV “Mbrojtja e Mjedisit në procesin e planifikimit” përcakton politiken e qeverisë për:

Politika shtetërore mjedisore – përcakton pozicionin e mjedisit në legjislacion, vendin e strategjive të sektoreve kombëtare dhe planet lokale si pjesë e politikës mjedisore dhe përcakton organizmat të cilët do të administrojnë këto politika.

Strategjite dhe planet mjedisore – përcakton Ministrinë si organin përgjegjës për hartimin periodik të strategjive dhe planeve mjedisore për secilin nga përbërësit e mjedisit.

Planet vendore të veprimit për mjedisin – kërkojnë nga qeverisja lokale të përgatitin plane veprimi vendore për mjedisin në mënyrë periodike në përputhje me strategjitë dhe planet e referuara në nenin 21 të këtij ligji. Kryetarët e njësive të qeverisjes vendore, në fillim të çdo viti, raportojnë në këshillin e qarkut për zbatimin e planeve vendore përkatëse për mjedisin, për vitin pararendës.

Planet e zhvillimit – përfshijnë instrumentet e parashikuara në planifikimin kombëtar, vendor e ndërvendor, dhe planifikimin e integruar dhe kërkojnë nga autoriteti publik përkatës të mbaje parasysh veçanërisht ndjeshmërinë e mjedisit të një zone të caktuar gjatë hartimit dhe miratimit të planeve të zhvillimit.

BAZA LEGJISLATIVE

Seksioni i mëposhtem i këtij raporti paraqet në mënyrë përmbledhese ligjet dhe normat përkatëse që janë marre në konsideratë.

Miratuar në vitin 1998, Kushtetuta e Shqipërisë përcakton kornizën e përgjithshme për mbrojtjen e mjedisit, si dhe miraton parimet e zhvillimit të qëndrueshëm dhe menaxhimin e qëndrueshëm të burimeve natyrore, si dhe të drejtën e publikut për lirinë e informacionit mbi mjedisin.

Kuadri ligjor vendor Legjislacioni mjedisor është ndertuar për të mbrojtur dhe parandaluar komponente të veçante dhe të rëndësishme të mjedisit. Kështu, ndër me specifiket mund të përmendim:

Kështu, ndër me specifiket mund të përmendim:

Ligjin Nr. 10 431, date 9.6.2011 "Per mbrojtjen e Mjedisit"

Ligji Nr.10 440, date 7.7. 2011, "Per vleresimin e ndikimit ne mjedis".

Ligj Nr. 10448, date 14.07.2011 "Per lejet e mjedisit"

Ligji Nr. 10 463, date 22.9. 2011 "Per menaxhimin e integruar te mbetjeve"

Vendim Nr. 177, date 6.3.2012 "Per ambalazhet dhe mbetjet e tyre" Ligj Nr. 10119 date 23.04.2009 "Per planifikimin e territorit" ligjit nr. 10266 datë 15.04.2010 "Për mbrojtjen e ajrit nga ndotja"

Ligji Nr.9587, date 20.07.2006, "Per mbrojtjen e biodiversitetit"

Ligji Nr.10 081, date 23.02.2009 "Per Licencat, autorizimet dhe lejet ne Republiken e Shqiperise".

VKM Nr. 686, date 29.07.2015, "Per miratimin e rregullave, te pergjegjesive e te afateve per zhvillimin e procedures se vleresimit te ndikimit ne mjedis (VNM) dhe procedures se transferimit te vendimit e deklarates mjedisore".

Vendim i KM Nr.1189, Date 18.11.2009 "Per Rregullat Dhe Procedurat Per Hartimin Dhe Zbatimin e Programit Kombetar Te Monitorimit Te Mjedisit"

Vendimi i KM Nr. 805, dt 04.12.2003 "Per miratimin e listes se veprimtarive, qe ndikojne ne mjedis, per te cilat kerkohet Leje Mjedisore".

VKM-së nr. 435 datë 12.09.2015 "Për miratimin e normave të shkarkimeve në ajër në Republikën e Shqipërisë".

Vendimi i KM Nr.247, date 30.04.2014 "Per terheqjen e mendimit te publikut ne vendimmarrje per mjedisin".

Vendim i KM Nr. 123, date 17.2.2011 "Per menaxhimin e zhurmave"

Vendim i KM Nr. 313, dt. 09.05.2012 "Per rregulloren e mbrojtjes se publikut nga shkarkimet ne mjedis"

Vendim i KM Nr. 99, date 18.2.2005 "Per miratimin e katalogut shqiptar te klasifikimit te mbetjeve"

Vendim i KM Nr. 177, date 31.3.2005 "Per normat e lejuara te shkarkimeve te lengeta dhe kriteret e zonimit te mjediseve ujore pritese"

Vendim i KM Nr. 538 dt.26.05.2009 "Per licencat dhe lejet qe trajtohen nga apo nepermjet QKL dhe disa rregulla te tjera"

Vendim i KM Nr. 16, date 14.01.2012 "Per te drejten e publikut per te pasur informacion mjedisor"

Vendim Nr. 676, date 20.12.2002 "Per shpalljen e zonave te mbrojtura monument natyror"

VKM Nr. 575, date 24.06.2015, "Per menaxhimin e mbetjeve inerte"

Udhezim Nr. 8, dt.27.11.2007 "Per nivelet kufi te zhurmave ne republiken e shqiperise. Ne parlamentin Shqiptar jane miratuar edhe disa ligje ne kuader te perfshirjes se vendit tone ne Protokolle dhe marreveshje te ndryshme. Nder to permendim:

Ligji Nr. 9672 date 26.10.2000: "Per ratifikimin e konventes se Aarhusit" Per te drejten e publikut per te pasur informacion dhe perfshirjen ne vendimarrje, si dhe per tju drejtuar gjykates per ceshtjet e mjedisit.

Ligji Nr. 9334 date 16.12.2004: "Per aderimin e Republikes se Shqiperise ne Protokollin e Kiotos" ne konventen per ndryshimet klimatike (UNFCCC).

Ligji Nr. 9424 date 06.10.2005: "Per ratifikimin e protokollit te vleresimit strategjik mjedisor". Ligji Nr. 9486 date 06.03.2006: "Per aderimin e Republikes se Shqiperise ne Amendamentin e Pekinit per protokollin e Montrealit" Per substancat qe hollojne shtresen e Ozonit.

Ligji Nr. 9548 date 01.06.2006: "Per aderimin e Republikes se Shqiperise ne protokollin per regjistrat e shkarkimit dhe transferimit te ndotesve"

Hartimi i kesaj VNM -je dhe zbatimi i ketij projekti eshte i mbikqyrur nga disa institucionet qendrore dhe ato lokale per zbatimin me rigoroz te te gjitha ligjeve dhe normave te parashtuara ne ligjet perkatese sipas institucioneve dhe kopentecave te tyre.

Hartimi i ketij raporti vnm eshte bere ne perputhje me ligjin nr. 10 440, date 07.07.2011, "per vleresimin e ndikimit ne mjedis", ku sipas shtojcave te ketij ligji, percaktohen edhe projektet qe i nenshtrohen procedures se vleresimit te ndikimit ne mjedis, dhe projekti ne fjale i nenshtrohen procedures paraprake te vleresimit te ndikimit ne mjedis Shtojca II, Pika 10. Prodhime infrastrukturore b) Projekte per zhvillime urbane, duke perfshire dhe ndertimin e qendrave tregtare dhe parkimet per makinat

TË DHËNA PËR SHTRIRJEN DHE VENDNDODHJEN E PROJEKTIT

**Projekti: "Ndërtim muri mbrojtës i trotuarit të segmentit Rruga e Kunes "
FRAN IVANAJ"**

Gjendja ekzistuese: Vendodhja e projektit është përgjate territorit të Bashkisë Lezhe .

• **PËRSHKRIMI I SHKURTËR I GJËNDJES:**

Në gjendjen aktuale rruget kanë karakteristika të njëjta, janë të hapësirë të cila përdoret nga makinat dhe banoret dhe janë në një gjendje të cila ka nevojë për tu trajtuar për të bërë më të lehtë kalimin e mjeteve dhe banorëve në këto rrugë. Gjendja e tyre aktuale pjesërisht është me cakull dhe ka nevojë për nderhyrje.

Statusi i zonës së studiuar

Ky projekt është vijueshmëria e investimeve që bëhen në teritorinë e Bashkisë Lezhe në ndihmë të banorëve. Segmentet rrugore kanë gjurmën ekzistuese por gjendja e tyre nuk është shumë funksionale prandaj ato do të rikonstruktohen.

Treguesit e projektit

Në altimetri, segmenti rrugor nuk ka pjerresi të theksuar.

1. INFORMACION PËR QËLLIMIN E VNM DHE METODIKËN E ZBATUAR

Përshkrimi qëllimit dhe objektivave të VNM

Ky Raport i Vlerësimit të Ndikimit në Mjedis, është hartuar bazuar në legjislacionin mjedisor për VNM dhe ka për qëllim që të parashikojë, identifikojë, vlerësojë dhe parandalojë ose minimizojë ndikimin në mjedis të projektit të propozuar.

Procedura e vlerësimit të ndikimit në mjedis përfshin:

- a) procesin paraprak të vlerësimit të ndikimit në mjedis;
- b) procesin e thelluar të vlerësimit të ndikimit në mjedis.

Objektivat afatshkurter të VNM janë:

- Permiresim nga pikepamja mjedisore të projektit të propozuar;
- Siguron që burimet natyrore janë përdorur në mënyrë të duhur dhe me efikasitet;
- Siguron që është përzgjedhur alternativa më e mirë e vendodhjes së projektit.
- Siguron që janë marrë në konsideratë teknikat më të mira të disponueshme të teknologjisë së propozuar për të aplikuar.
- Identifikon masat e duhura për zvogëlimin e ndikimeve të mundshme potenciale të projektit të propozuar;

-
- Mundeson informimin e vendim-marresve, duke gjykuar ne miratimin ose jo te projektit dhe kushteve qe duhet te vendosen ne aktin e miratimit.

Objektivat afatgjate te VNM jane:

- Siguron dhe mbron shendetin e njeriut;
- Parashikon dhe parandalon ndryshimet/demtimet e pakthyeshme te mjedisit;
- Ndikon ne mbrojtjene burimeve natyrore, peisazhet e natyres dhe komponentet perberes te ekosistemeve;
- Permireson aspektet sociale-ekonomike te projektit
- Ndhmon ne realizimin e parimit te zhvillimit te qendrueshem te mjedisit

Përshkrim i përmbledhur i kuadrit ligjor mjedisor dhe institucional që lidhet me projektin Legjislacioni mjedisor eshte hartuar per te mbrojtur dhe parandaluar ndotjen dhe demtimin e komponenteve te veçante dhe te rëndesishem te mjedisit nga faktore te ndryshem, njerezore dhe natyrore. Nder ligjet me kryesore ne lidhje me kete projekt, mund te permendim:

- Ligji Nr. 10431 datë 09.06. 2011 “Për Mbrojtjen e Mjedisit”.
- Ligji Nr. 10440 datë 07.07. 2011 “Për Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis”.
- Ligj Nr. 10448, date 14.07.2011 “Per Lejet e Mjedisit”.
- Ligji Nr. 10463 date 22.09.2011 “Per menaxhimin e integruar te mbetjeve”.
- Ligji Nr.8897 datë 16.05.2002, “Për mbrojtjen e ajrit nga ndotja”, i ndryshuar.
- LIGJ Nr. 57/2020 “PËR PYJET”,
- Ligji Nr.9587, datë 20.07.2006, “Për mbrojtjen e biodiversitetit”.
- Ligji Nr. 124/2015 datë 12.11.2015 “Për eficiency e energjisë”
- LIGJIN NR. 10 463, DATË 22.9.2011, “PËR MENAXHIMIN E INTEGRUAR TË MBETJEVE”, TË NDRYSHUAR
- Ligjin Nr. 111/2012 “Për menaxhimin e integruar të Burimeve ujore”,
Vendim i KM Nr. 123, datë 17.2.2011 “Per menaxhimin e zhurmave”.
- Vendim i KM Nr. 313, dt. 09.05.2012 “Per rregulloren e mbrojtjes se publikut nga shkarkimet ne mjedis”.
- Vendim i KM Nr. 686, date 29.07.2015 “Per zhvillimin e procedures se Vleresimit te Ndikimit ne Mjedis”.
- Vendim i KM Nr. 247, datë 30.4.2014 “Për përcaktimin e rregullave, të kërkesave e të procedurave për informimin dhe përfshirjen e publikut në vendimarrjen mjedisore”.
- Vendim i KM nr. 402 datë 30.06.2021 “Për miratimin e katalogut të klasifikimit të mbetjeve”

-
- Vendim i KM Nr. 575, datë 24.6.2015 “Për miratimin e kërkesave për menaxhimin e mbetjeve inerte”
 - Udhezim Nr. 8, dt.27.11.2007 “Per nivelet kufi te zhurmave.

Shenim:

Raporti i Vleresimit te Ndikimit ne Mjedis, hartohet per fazen e kryerjes se punimeve te rikonstruksionit dhe ndertimit te nje shtese 4 katëshe, si dhe gjate fazes se funksionimit te tyre. Ky raport paraprak i Vleresimit te Ndikimit ne Mjedis, do te paraqitet prane Ministrise se Mjedisit dhe Agjencise Kombetare te Mjedisit, per tiu nenshtruar procedures paraprake te Vleresimit te Ndikimit ne Mjedis nga Agjencia Kombetare e Mjedisit, sipas kerkesave te Ligjit Nr. 10440, date 07.07.2011 Per VNM, Shtojca II dhe VKM Nr. 686, date 29.07.2015 Per VNM.

PËRSHKRIMI I MBULESËS BIMORE TË SIPËRFAQES KU PROPOZOHET TË ZBATOHET PROJEKTI

Bashkia e Lezhës, e vendosur në veri-perëndim të Shqipërisë, karakterizohet nga një mjedis natyror i pasur dhe i larmishëm. Falë pozitës së saj gjeografike, që përmban ekosisteme malore, fushore, pyjore, lagunore dhe bregdetare, këtë zonë e përshkon një biodiversitet i rrallë në nivel kombëtar dhe rajonal. Flora dhe fauna e Lezhës përfaqësojnë një pjesë të konsiderueshme të Listës së Kuqe të Shqipërisë, me disa lloje që konsiderohen të rrezikuara apo të mbrojtura.

Flora e Bashkise Lezhe Flora e Bashkisë së Lezhës është e pasur dhe e larmishme, duke përmbajtur një mori specimesh bimore të cilat rriten në pyje, livadhe, fusha dhe zona bregdetare.

- **Zona pyjore:** Pyjet e Lezhës janë të dominuara nga dushku (*Quercus ilex*), i cili është një nga speciet më të rëndësishme pyjore në Shqipëri. Këto pyje kanë gjithashtu prezencën e ilqeve, shelgjeve (*Salix alba*) dhe llojeve të tjera tipike të zonës mesdhetare.
- **Shkurret dhe bimësitë mesdhetare:** Bimët tipike të shkurretave të ulëta mesdhetare janë *Pistacia lentiscus*, *Pistacia terebinthus* dhe *Rosa sempervirens*. Këto bimë janë të përhapura në zonat me shpatet e ngrohta dhe të thata.
- **Bimësitë lagunore:** Në afërsi të lagunës Kune-Vain ndodhen bimë të posaçme, si kallamishtet (*Phragmites australis*), të cilat krijojnë habitate të rëndësishme për shpendët shtegtarë.

Fauna e Bashkise Lezhe Fauna e Lezhës është një tjetër pasuri e madhe, duke përmbajtur një shumëllojshmëri të specieve të rëndësishme për ekosistemin lokal dhe më gjerë.

- **Gjitaret:** Gjatë eksplorimeve, në këto zona janë identifikuar disa lloje gjitarësh të rëndësishëm, si ujku (*Canis lupus*), dhelpra e kuqe (*Vulpes vulpes*) dhe derri i

egër (*Sus scrofa*). Një nga speciet më të rralla të kësaj zone është foka e Mesdheut (*Monachus monachus*), e cila konsiderohet një nga gjitarët më të rrezikuar detarë në botë.

- **Shpendët:** Zonat lagunore, si laguna Kune-Vain, përfaqësojnë një habitat kryesor për shpendët e ujit dhe ato shtegtarë. Këtu mund të shihen lloje si pelikani (*Pelecanus crispus*), rosa e egër (*Anas platyrhynchos*), flamingoja rozë (*Phoenicopterus roseus*) dhe dallëndyshet. Këto zona përdoren si vende pushimi gjatë migrimit sezonal të shpendëve.
- **Amfibët dhe reptilët:** Në zonat e lagëta të Lezhës, si përreth lagunave dhe kënetave, janë të pranishëm bretkosat, breshkat e ujit dhe disa lloje gjarpërësh si gjarpri i ujit (*Natrix natrix*).
- **Peshqit dhe fauna detare:** Laguna Kune-Vain është një nga zonat më të rëndësishme për peshkimin artizanal. Peshq si levreku (*Dicentrarchus labrax*), kocja (*Sparus aurata*) dhe ngjala (*Anguilla anguilla*) gjenden me shumicë në këto ujëra. Zona e bregdetit ka gjithashtu një pasuri të madhe të peshqve të vegjël dhe specieve detare si karkalecat dhe krustacët.

Vlerat Mjedisore dhe Rëndësia Ekologjike Flora dhe fauna e Lezhës ka vlera të jashtëzakonshme mjedisore. Këto zona janë thelbësore për ruajtjen e llojeve të rëndësishme dhe për garantimin e ekuilibrit ekologjik. Laguna Kune-Vain është një prej zonave më të rëndësishme në kuadër të rrjetit ekologjik "Natura 2000".

INFORMACION PËR PRANINË E BURIMEVE UJORE, NË SIPËRFAQEN E PROJEKTIT DHE NË AFËRSI TË TIJ

Lezha me zonat përreth është një ndër rajonet e Shqipërisë më të pasura me ujra. Kjo pasuri ujore e saj përbëhet kryesisht nga ujrat e detit Adriatik që lagin brigjet e këtyre zonave, ato të rrjetit hidrografik, ujrat e lagunave në të dy anët e grykëderdhjes në det të lumit Drin i Lezhës dhe ujrat nëntokësore të fushës së Lezhës. Lezha dhe zonat përreth janë të pasura gjithashtu me reshje atmosferike të bollshme të cilat janë kryesisht rreshje shiu dhe shumë rrallë rreshje bore. Sasia mesatare vjetore e tyre është 1460 mm në vit. Rreshjet maksimale ditore të matura janë 160 mm në 24 orë. Numri i ditëve me reshje është 120 ditë në vit. Rrjedhjet ujore më të rëndësishme që formojnë këtë rrjet hidrografik janë lumi Drin i Lezhës dhe lumi Gjadër. Lumi Drin ka qenë elementi kryesor i sistemit dhe i rrjetit hidrografik të Lezhës dhe i zonave përreth. Vetë ky sistem hidrografik në një shkallë të konsiderueshme është rrjedhojë e veprimatrisë dhe e prurjeve të ngurta që lumi Drin ka përcjellë në shekuj në detin Adriatik. Por sot, ky lumë nuk kalon më në shtratin e tij shekullor, përbri qytetit të Lezhës. Ai nuk i derdh më ujrat e tij në det, por në lumin Buna. Është ndofta rast shumë i rrallë, për të mos thënë unikal, që një lumë kaq i madh me ndërhyrjen e ndërjegjeshme edhe të vetë njerëzve, ndryshon tërësisht rrjedhën e tij. Lumi Drin është lumi më i madh i Shqipërisë dhe i dyti për sa i përket ujshmerisë, mbas lumit Buna. Ai është lumi më i madh në tërë bregdetin Adriatik të gadishullit Ballkanik.

Klima

Klima e përshtatshme dhe shumë e butë bën që Lezha gjatë tërë vitit të jetë vend dominant për pushime dhe turizëm. Numri i ditëve me diell në vite mbi 260 ditë, i orëve vjetore 2340, ose 6,5 orë në ditë. Kurse gjatë verës mbi 10 orë në ditë, duke dominuar zonën në Adriatik. Klima është tipike mesdhetare me verë të thatë e të nxehtë dhe dimër të butë. Nga deti fryn era e freskët duke freskuar ditët e gjata të verës me temperatura mbi 25 gradë. Të gjitha kushtet së bashku garantojnë një sezon për larje dhe marrje rreze dielli deri në 6 muaj nga muaji Maj deri në fund të Tetorit. Në lezhë vihet për diell, det, plazhe të rërës, bukuri të natyrës dhe për vendas mikpritës e të shoqërueshëm. Me fillimin e sezonit zona e bregdetit merr një jetë të re, duke u dhjetëfishuar numri i banorëve. Pjesa më e madhe e këtyre vizitorëve vijnë nga Shkodra, Tirana, Laçi, Mirdita, Kukësi, kruja, Burreli, dibra dhe këto dy vitet e fundit edhe nga Kosova dhe Mqedonia. Bregdeti i lezhës frekuentohet nga pushuesit edhe si vend i qetë dhe i sigurt. Në gjithë vijën e bregdetit do të gjeni një panoramë të pasur me pyje dhe me lagunat e veçanta shoqëruar me florën dhe faunën e pasur si dhe do të vëzhgoni traditat e kësaj zone në gjueti dhe në peshkim. E veçanta e këtij plazhi është rëra e pasur me jod dhe që është vlerësuar si rëra më kurative në bregdetin e Adriatikut. Rripi i gjerë i rërës së pastër është i kufizuar nga njëra anë me detin ndërsa nga ana tjetër me pyllin, ku kryesisht rriten pishat, por nuk mungojnë edhe lloje të tjera drurësh të kultivuar.

Gjeologjia dhe Dherat

Ne ndertimin gjeologjik hyjne gelqeroret e dolomitizuar te Kretakut te Siperme Cr2, reshpet argjilore, flishi alevritë-ranorë-mergelor i Kretak i Siperme Maastrichtian - Paleogen i Mesetn Cnm Pg2, depozitime te Paleocen-Eocenit Pg1-2, gelqeroret e Eocenit Pg2, reshpet argjilë - alevrolitë - ranorë te Oligocenit te Poshtem si dhe sedimente te Pleistocen - Holocenit (Kuatemar). Pjesen kryesore te planshetit e dominojne sedimente te Pleistocen - Holocenit (Kuatemar). Pershkrimi i gjeologjise per planshetin eshte bere sipas zonave tektonike, nga moshat me te vjetra deri tek me te rejat. Me poshte sipas moshave po i trajtojme me hollesisht:

- **Depozitimet e Kretaku i Siperme -Cn** Keto depozitime perhapen ne skajin me jug - perendimor te siperfaqes se planshetit. Ato ndertojne plotesisht vargmalin e Kakarriqit. Depozitimet e Kretakut te Siperme, perfaqesohen nga gelqerore, gelqerore te dolomitizuar dhe dolomite. Gelqeroret paraqiten shtrese trashe deri masiv, rralle shtrese mesem kane ngjyre te bardhe qumeshti. Dolomitet formojne ne pergjithesi pako potente, por paraqiten edhe shtrese holle. Ne siperfaqe dallohen lehte nga gelqeroret sepse kane ngjyre gri te erret. Mbi gelqeroret e karstezuar te Kretakut te Siperme vendoset mineralizimi boksitifer, i cili mbush thellimet, gropat apo te carat karstike. Ne raste shume te rralla gelqeroret e Kretakut te Siperme mbulohe nga gelqeroret e Paleogjenit pa patur mineralizim boksitifer. Shtrirja e gelqeroreve eshte veriperendimjuglindje dhe kane renie VL me 40-45 grade. Trashesia e tyre arrin deri ne 950 m, kane forme te rrudhosur, sepse jane vazhdim i gelqetoreve te planshetit Trush.

Kontakti me gelqeroret e Eocenit eshte me pushim. - Depozitimet e Kretak i Siperm Maastriktian - Paleogen i Mesem Cnm P1-2

- **Depozitimet e Kretak i Siperm Maastriktian ~ Paleogen i Mesem Cnm- Pg-2** perfaqesohen nga flish alevrito-argjilo-mergelor. Ne siperfaqen e planshetit keto depozitime dalin vetem ne pjesen juglindore dhe kane perhapje shume te vogel.

- **Depozitimet e PaJeocen - Eocen Pg_{1,2}** Depozitimet e Paleocen - Eocenit perfaqesohen nga rreshpe argjilore, argjilo - alevrolitikoranorike, argjilo - sericitike me nderfutje te ranoreve polimik. Ne siperfaqen e planshetit keto depozitime takohen ne formen e nje brezi te cegullt duke filluar nga qendra deri ne juglindje, nga fshati Plezhe - Kullez dhe vazhdojne drejt JL deri ne lumin e Gjadrit, afer fshatit Dajc te Hajmelit. Takohen edhe ne fonde njollash te vogla ne jug - lindje dhe lindje te tij. Prerja fillon me nje pako mergelore apo argjilo - mergelore, me trashesi 10-12 m, mbi mergeloret e kuq, vijon me nje flish argjilo - ranor, ne pergjithsi ritem holle, me shtresa te holla gelqerorësh turbititike me makroforaminifere, si dhe vende vende me olistolitike te vegjel te shkembinjve karbonatike me te vjeter. Kane orientim lindje - perendim dhe renie afro veriore me kende 35 - 45 grade. Per efekt te mbihypjes se zones Krasta - Cukali mbi ate te Krujes, keto depozitime paraqiten shume te rrudhosura. Trashesia e pergjithsbme e tyre nuk i kalon 250m dhe kane shtrirje VP - JL me renie VL me kend 35-40 grade. Depozitimet e Pg_{1,2} sherbejne edhe si dysheme mbi te cilat shtrihen depozitimet e Kuaternarit.

- **Depozitimet e Eocen - Pg2** Depozitimet e Eocenit, perfaqesohen nga gelqerore biogjene me shtresezim te qarte shtrese holle deri shtrese mesem, me ngjyre bezhe me nuance gri deri gri te erret. Ne planshet i takojme ne pjeset me te uleta hipsometrike ne veri - lindje te vargmalit te Kakarriqit, duke zene nje siperfaqe te kufizuar ne siperfaqen e planshetit. Keto depozitime vendosen transgresivisht nepemjet nje shtrese te holle argjilash boksitike e here boksidesh te dobeta mbi depozitimet karbonatike te Kretakut te Siperm. Brenda tyre ne vende te ndryshme verehen dhe linza strallesh. Bien me kende te forta deri ne strulcture te permbysur kjo sidomos ne anen e shpatit te Kakarriqit. Trashesia e tyre eshte rreth 200 m, gjatesia e brezit rreth 2 km dhe gjeresia e tij arrin deri 200m. Keto depozitime kane shtrirje VP-JL me kend 45 grade dhe kontakti me gelqeroret e Kretakut te Siperm eshte me pushim stratigrafik. -

- **Depozitimet e Oligocenit t~ Poshtlm-Pg.2.¹** Depozitimet e Oligocenit te Poshtem, flishi Kruja - perfaqesohen nga rreshpe argjilore dhe nga argjilo -silicore dhe me pak argjilo - ranorike, konglomerate dhe rralle gelqerore, gelqerore mergelore. Ne siperfaqen e planshetit te Barbullushit takohen ne kuotat me te larta te kodrra Melgushe - Bushat dhe me ne jug ne kodren e Barbullushit, ne formen e nje brezi te gjere me nderprerje nga depozitimet e Kuaternarit. Dominimi i depozitimeve te Oligocenit te Poshtem alterohet si ne shtrirje dhe ne renie. Zakonisht zonat e ngritura te kodrave ndertohen nga dominimi i konglomerateve, ranoreve dhe gelqeroreve. Trashesia e tyre arrin deri ne 600 m, kane shtrirje VP - JP dhe renie VL me kend 40-50 grade dhe sherbejne si dysheme mbi te cilat zhvilloben depozitimet e kuaternarit

- **Depozitimet Kuartenare Sedimentet e Kuaternarit** ne kete planshet zene nje siperfaqe te konsiderueshme. Sipas kohes se formimit po i trajtojme si me poshte: Depozitimet e Holocenit (c,d,p,Qp3-h), depozitimet kenetore (kQh2), depozitimet aluviale te Holocenit (alQh) - Depozitimet e Holocen (c,d,p,Qp3-h)

- **Depozitimet e Holocenit** perfaqesohen nga rera, zhavorre dhe alevrite. Keto sedimente takohen ne perendim te planshetit, ne qender dhe vazhdojne drejt JP dhe shuihen ne trajta te rregullta, takohen ne fshatrat Shkjeze, Maba. Barbullush, etj. Trashesia tyre arrin deri ne 20m. Ne sektorin perendimor keto depozitime zhvillohen mbi rreshtet argjilo - alevrolito - ranore te Oligocenit te Poshtem, ndersa ne qender zhvillohen mbi flishin alevrolitor te PaJecen - Eocenit.

- **Depozitimet aluviale ti (aJQh- alQh2)** Depozitimet aluviale te alQh jane sedimente fluviale te Holocenit, perfaqesohen nga zhavorre, alevrite, argjila dhe rera, ndersa depozitimet aluviale alQh2 jane depozitimet e Holocenit te vonshem, perfaqesohen nga zhavorre, alevrite, argjila. Ne siperfaqen e planshetit depozitimet aluviale te alQh perhapen pothuajse ne gjithe pjesen fushore, duke u shtrire ne te tere sektoret e tij, nga lindja ne perendim dhe nga veriu ne jug, ne fshatrat Bushat, Stajka, Kozmat, Ranxa, Melgush, Stajk, etj, me trashesi deri ne 100m, ndersa depozitimet e alQh2 takohen vetem ne veri te siperfaqes se planshetit.

- **Depozitimet kenetore (kQb2)** Depozitime kenetore (kQh2) perfaqesohen nga argjila, alevrite, rera dhe torfe. Keto jane sedimente te reja, te pa konsoliduara, trashesia e tyre arrin deri ne 18 m. Ne keto sedimente predominon Jeta bimore ne dekompozim e siper. Ne siperfaqen e planshetit shtrihen ne nje zone te kufizuar ne lindje ne fshatrat Pam, Pistull duke vazhduar drejt veri - lindjes deri afer fshatit Kace.

Komuniteti lokal dhe social-ekonomia

Qarku i Lezhës ndodhet në pjesën veriperëndimore të Shqipërisë e cila kufizohet: në veri me qarkun Shkodër, në verilindje me qarkun Kukës, në lindje dhe juglindje me qarkun Dibër, në jug me qarkun Durrës dhe në perëndim me detin Adriatik, me gjatësi vije bregdetare 38 km (nga Rëra e Hedhun deri në Kepin e Rodonit).

Territori i qarkut të Lezhës ka një sipërfaqe prej 1 619 km² dhe shtrihet në krahinën malore-qendrore dhe ultësirën perëndimore, ku 65% e sipërfaqes shtrihet në zonën kodrinore-malore dhe 35% në zonën fushore. Relievi në këtë rajon prezanton kontraste të theksuara të të gjitha llojeve si bregdetar, fushor, kodrinor, malor, alpin etj me një alternim ndërmjet tyre si në asnjë rajon tjetër të vendit, ku deti, fusha dhe malet janë shumë pranë njëri tjetrit. Lartësia mesatare mbi nivelin e detit të rajonit të Lezhës është 413 m, ajo maksimale 2121m (maja e Kunorës Mirditë) dhe minimale -4 deri -6 m (Nallë, Torovicë, Kakarriq, Tresh etj në Lezhë).

Popullsia nga Censusi 2011 rezulton 2 842 925 banorë në rang kombëtar. Në qarkun e Lezhës jetojnë 136 612 banorë, që përbëjnë 4.8% të popullsisë së vendit. Po të bëjmë një krahasim me vitin 2001 vëmë re se popullsia në 2011 është ulur si në rang kombëtar ashtu dhe në qarkun e Lezhës. Kjo ulje e numrit të popullsisë ndër vite ka ardhur si pasojë e lëvizjes gjithnjë e më tepër të popullsisë drejt qarkut të Tiranës. Në Vitin 2001 kemi 3 067 740 banorë në rang kombëtar , nga të cilët

159,149 ndodhen në qarkun e Lezhës , pra që përbëjnë 5.2%. Shohim se përqindja e popullsisë së qarkut të Lezhës ndaj totalit kombëtar ka ardhur duke u ulur nga viti 2001 në 2011.

Zhvillimi Ekonomik

Në kontekstin e zhvillimit ekonomik, nëse do të shohim indikatorët e tregut të punës për këtë qark, shohim se kemi një kontribut të ulët në raport me qarqet e tjera. Numri i ndërmarrjeve ekonomike që operojnë në Qarkun e Lezhës është 3030 ndërmarrje për vitin 2011. Në përqindje, themi se vetëm 3% e ndërmarrjeve ekonomike janë vendosur në këtë qark.

Tregues të rëndësishëm ekonomik për zhvillimin e qarkut janë papunësia dhe ndihma ekonomike që marrin familjet. Për vitin 2012, katërmujorin e fundit, numri i të papunëve në këtë qark është 15021 individë. Pra qarku i Lezhës renditet i pesti për nga numri i të papunëve, pas Qarkut të Tiranës, i cili përmban numri më të lartë të të papunëve, Qarkut Shkodër, Elbasan dhe Fier. Shprehur në përqindje niveli i papunësisë për këtë qark është 11% ndërsa në rang kombëtar është 12.82%.

IDENTIFIKIMI DHE KARAKTERIZIMI I NDIKIMEVE SOCIALE DHE MJEDISORE

Në kete kapitull analizohen e karakterizohen ndikimet sipas fazave të zhvillimit të projektit, duke konsideruar si fazën e ndertimit, ashtu edhe atë të funksionimit dhe mirëmbajtjes. Në analizë merren në shqyrtim të gjithë elementet mjedisore dhe jepen efekte e pritshme negative per secilin element mjedisor. Aktiviteti ekonomik, popullësia dhe levizshmëria e mjeteve është e madhe duke e konsideruar si një ndikim të rëndësishëm. Por konsiderohet i një niveli te ulët duke marrë parasysh aktivitetet që do të kryhen gjate punimeve.

Ndikimet mjedisore e sociale të projektit janë konsideruar në dy fazat e tij; atë të ndertimit dhe të funksionimit. Nëse faza e ndërtimit ka një qartësi kohezgjatjeje, ajo e operimit dhe/apo e mbylljes janë krejtësisht të varura nga mirëmbajtja e objekteve.

NDIKIMET SOCIAL-EKONOMIKE TE PROJEKTIT

Për vete natyrën e territorit ku do të kryhen punimet per ndërtimin e objektit, duhet theksuar fakti që ky projekt nuk prek në mënyrë negative prona private apo aktivitete ekonomike, vlera sociale etj. Gjithashtu, nuk pritet te shkaktojë demtime të vlerave ekonomike apo aktiviteteve të biznesit dhe karakteristikave sociale. Duke qënë një objekt i cili eshte ne nje zone te populluar pritet të ketë ndikime ne trafikun e zonës

Implementimi i projektit kërkon specialistë dhe punëtorë. Numri i punëtorëve që do të punojnë për ndërtimin do të jetë nje burim punësimi për punëtorë të kualifikuar dhe jo të kualifikuar gjatë gjithë periudhes. Kjo do te sjellë një impakt pozitiv tek popullsia vendase të cilët do të perfitojnë në dy mënyra nga ndërtimi: - Krijimin e punesimit direkt

- Fitimi indirekte për bizneset vendase

Ndikimet ne mjediset specifike social kulturore

Ndër ndikimet negative socio-kulturore ndonëse klasifikohen ne ato gjatë fazes së ndertimit dhe ato gjate fazes se veprimit, janë konsideruar vetem të parat. Gjate fazës operuese nuk pritet të ketë ndikime mbi vlerat arkeologjike, historike apo kulturore etj.

Aktiviteti qe kryhet nuk prek zonat turistike, zona te mbrojtura, zona arkeologjike, arkitekitektonike.

Ndikimet e përgjithshme ndërtimore dhe orientime per masat zbutëse

Territori i punimeve gjate fazës së ndërtimit do të kufizohet në minimumin e mundshëm te sipërfaqeve te objektit qe do te ndertohet.. Per te gjitha rastet do te merren masa te menjehershme sipas planit te menaxhimit te paraqitura ne kapitullin e meposhtem.

Ndikimet ne burimet ujore

Ndërtimi dhe rikonstruksioni i objektit ka si impakti potencial ndotjen e ujrave sipërfaqesore si rezultat i germimeve per themelet, mbetjet, baltat e gjeneruar nga perdorimi i makinerive te renda ose shkarkimi aksidental i lubrifikateve, solventeve, bojrave dhe vajrave.

Ndikimet e mundshme gjatë fazës se ndertimit

Sistemi i ujrave sipërfaqesore pritet të pësojë ndikim gjatë fazës së ndërtimit si rezultat i punimeve me germime, nga mbeturinat, balta e gjeneruar nga përdorimi i makinerive të rënda ose nga derdhja aksidentale e lubrifikantëve, vajrave, naftës etj. Persa i perket ujarve nentokesore dhe habitateve ujore të zonës jane të pasura por ndodhen larg zonës ku do te punohet dhe ndikimi konsiderohet i ulët.

Ndotjet aksidentale të ujrave sipërfaqesore e nëntokësore, mund të ndiqen nga pasoja në shendet, shkaterrim te habitateve etj. Këto pasoja mund të vinë si rezultat germimeve për hapjen e themeleve. Per te parandaluar ndotjet aksidentale, apo evituar pasojat e tyre, vëmendje e veçantë do ti kushtohet respektimit te rregullave teknike dhe aplikimit te eksperiencave me te mira inxhinierike ne lidhje me rastet e aksidenteve.

Ndikimet e mundshme gjate fazes së funksionimit te projektit

Nuk pritet të ketë ndikime të konsiderueshme negative gjatë fazes së operimit. Në raste te demtimeve të elementeve funksionale te objektit, si impakti potencial është ndotja e ujrave sipërfaqesore nga mbetjet, baltat e gjeneruar nga perdorimi i makinerive te renda ose shkartkimi aksidental i lubrifikateve, solventeve, bojrave etj. Nëse nje fenomen i tille ndodh, do të ketë impakt te konsiderueshëm.

Ndikimet negative ne toke dhe mbetjet

Edhe ndikimet negative në tokë janë parashikuar si për fazën e ndërtimit edhe për atë të funksionimit/mirëmbajtjes. Për të paracaktuar ndikimet ne tokë duhet analizuar e gjitha zona në të cilën do te kyhet ndertimi.

Ndikimet e mundshme gjatë fazës së punimeve

Bazuar ne kete tip projekti mbetjet nga ndërtimi jane te konsiderueshme duke marre parasyh se kemi te bejme me nje objekt egzistues dhe ndertim te ri. Pritet qe ndikimi ne toke te jete mesatar duke marre parasysh punimet qe do te kryhen. Duke u bazuar ne studimet e tokes dhe karakteristikave te saj jane marre parasysh ne fazen e ndertimit te objektit. Ndikime te tjera mund te jenë dhe sintetike, të vajrave lubrifikante dhe te materialeve te ndertimit, te cilat do te gjenerohen nga punetoret. Ndotja e tokes, gjate ndërtimit mund të ndodhe nga depozitimi i mbetjeve aksidentale nga makineritë.

Në varesi te tipit të ndotjes do të mund te percaktohet nese dëmi është afatshkruter apo afatgjate. Megjithate madhësia e ketij impakti pritet që të jetë mesatare.

Ndikimet e mundshme gjatë fazes se shfrytezimit të projektit

Ndikimet negative të mundshme gjatë fazës se shfrytezimit, mbeten ato të natyres aksidentale. Keto ndikime mund të rrezikojnë seriozisht ndotje dhe kontaminim te tokës të cilat mund të vijnë nga erozioni.

Ky projekt ndodhet në një zonë fushore urbane dhe rreziku i erozionit nuk parashikohet te jete prezent.

NDIKIMET NË AJËR

